



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:169340

Datë: 12.08.2024

Numri i dokumentit: 06041786

P.nr. 297/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sek.juridike Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale kundër të pandehurit R.Sh...rruga ,,..., afër ,,..., me mbrojtësin me autorizim av. Halit Azemi, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.1284/22 të datës 25.08.2022, të cilën e përfaqëson Prokurorja e Shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datën 10.07.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **R.SH...**, nga babi R., nëna R., e gjinisë B..., i lindur me datë ..., në fshatin Z..., K. Bujanoc, me vendbanim në Gj..., rruga ,,..., afër ,,..., ka të kryer shkollën fillore, pensioner, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike nr. personal ..., me nr. të telefonit 045/...shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës; më parë i pa dënuar ndërsa nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 10.06.2022, në kohë të papërcaktuar, në Gjilan, lagja „Zabeli i Sahit Agës”, afër shkollës së mesme të bujqësisë, inspektorët e ndërtimit të komunës së Gjilanit, kanë konstatuar se i pandehuri R.Sh...si investitor, ka ndërmarrë veprime që bien ndesh me rregullat e ndërtimit, ashtu që, në objektin, në lagjen „Zabeli Sahit Ages”, ka filluar ndërtimin e objektit pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimore, si dhe nuk ka respektuar vendimin e inspektorit të drejtorisë së inspektoratit komunal në Gjilan, me numër 14-2-189/2022 të datës 18.05.2022, për ndërprerje e punimeve, por ka vazhduar me punët ndërtimore dhe atë pa i përfill dispozitat ligjore për tu pajisur me leje ndërtimi,

-Me çka ka kryer veprën penale, Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s;

E G J Y K O N

I. Të pandehurit R.Sh..., për veprën penale Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s, i shqiptohet denim kumulativ:

- **Denim me gjobë 300 (treqindë) euro, dhe**
- **Denim burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.**

II. Në bazë të nenit 44 të KPRK-s, dhe me pëlqimin e të pandehurit R.Sh..., denimi me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i **ZËVENDËSOHET** në dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I pandehuri R.Sh...ka për të paguar **shumën në total prej 900 (nëntëqind) euro** në afat prej 60 ditë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

IV. Obligohet i pandehuri që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

V. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë financiare në shumën prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë) euro dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.08.2022, ka ngritur aktakuzë, me numër të lëndës PP.II.nr. 1284/2022, kundër të akuzuarit R.Sh..., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar publik të datës 10.07.2024 prezent ishin prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, dhe i pandehuri R.Sh...me mbrojtësin me autorizim av. Halit Azemi. Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shteti, në këtë seancë, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit të aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorës së shtetit dhe palëve, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit R.Sh..., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri R.Sh...ka kryer veprën penale Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s;

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të pandehurin R.Sh...për shkak të veprës penale Ndërtimi pa leje, nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysht të gjitha rrethanat

dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të pandehurin R.Sh...si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, i pandehuri është penduar, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale është në moshë të shtyer, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjsinë penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit R.Sh..., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 450 paragrafi 1 të KPP, ka obliguar të pandehurin ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor si dhe konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të detyroj të pandehurin të paguaj taksën për viktimat e krimit (Ligji nr.08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 297/2024, më datën 10.07.2024**

Sek. Juridike,
Fatmire Sermaxhaj

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.